

LANGUAGE TENDENCIES IN THE ALBANIAN DIGITAL SPHERE PRIRJET GJUHËSORE NË SHQIPEN DIGJITALE

Shadan RAMADANI¹, Gjuliano ISEINI², Faik IDRIZI³

¹Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

²Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

³Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

Corresponding author e-mail: shadan.ramadani@unite.edu.mk, gjuliano.iseini@unite.edu.mk, faik.idrizi@unite.edu.mk

Abstract

The technological revolution in recent decades has enabled the transition from traditional writing to paper to digital, which also affects its textual characteristics. As with all other languages used on the Internet, writing on the Internet has inevitably changed the Albanian language as well. The digital language today is not only defined by the means of communication, but also from other extra-linguistic factors such as the age, origin, social-economic status of the users, but also from the purpose of the written texts. Changing linguistic tendencies in the Albanian digital sphere reflect social, technological, and cultural changes.

The most common are borrowings, abbreviations, and acronyms, moving towards a simpler and faster language. These tendencies reflect the transformation of the Albanian language in a global and digital environment, simultaneously preserving its unique identity while adopting new elements that characterize the new form of writing in social networks. New orthographic features appear in forms, such as vowel lengthening, punctuation, and expressive spelling. In terms of morphology, suffixes and prefixes contribute significantly to strong linguistic expression. On the syntactic level, split sentences and dislocations are common.

Keywords: Digital Media, Communication, Language tendencies

Abstrakt

Revolucioni teknologjik në dekadat e fundit ka mundësuar kalimin nga shkrimi tradicional në letër deri në atë digjital, që gjithashtu ndikojnë mbi karakteristikat e tij tekstuale. Shkrimi në internet ka modifikuar në mënyrë të pashmangshme si gjuhën shqipe ashtu edhe të gjitha gjuhët e tjera të përdorura në internet. Gjuha digjitale sot nuk është e përcaktuar vetëm nga mjetet e komunikimit, por edhe nga faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë si mosha, origjina, statusi social-ekonomik i përdoruesve, por edhe nga qëllimi i teksteve të shkruara.

Prirjet gjuhësore në shqipen digjitale përfaqësojnë një zhvillim interesant dhe dinamik që reflekton ndryshimet sociale, teknologjike dhe kulturore. Kryesisht janë **përdorimi i huazimeve, shkurtime dhe akronimet, lëvizja drejt një gjuhe më të thjeshtë dhe më të shpejtë**. Këto prirje reflektojnë transformimin e shqipes në një mjedis global dhe digjital, duke ruajtur njëkohësisht identitetin e saj unik ndërkohë që adopton elemente të reja, që karakterizojnë formën e re të shkruarit në rrjetet sociale.

Në rrafshin drejtshkrimor, tiparet e reja paraqiten në formë dhe, në këtë rast, zgjatja e zanoreve, shenjat e pikësimit dhe drejtshkrimi shprehës. Në nivel morfologjik, vihet re një prirje drejt shprehjes së fortë gjuhësore e cila përftohet nëpërmjet mekanizmave të prapashtesave dhe parashtesave. Sa i përket nivelit sintaksor, dislokimet dhe fjalitë e ndara janë të shpeshta.

Fjalët kyçe: media digjitale, komunikimi, prirjet gjuhësore

Hyrje

Gjuha na lejon të shprehim idetë, emocionet dhe përvojat tona, pa të, do të ishte e vështirë të ndanim ndjenjat dhe të ndërvepronim në një nivel të thellë me të tjerët. Transmetimi i informacionit mund të bëhet përmes mënyrave të ndryshme të komunikimit, të cilat ndahen në verbale, paraverbale dhe joverbale, në varësi të gjuhës së komunikimit të përdorur. Ndërsa përvoja personale e secilit prej nesh tregon se nuk është e rëndësishme vetëm përmbajtja e

fjalëve që shqiptojmë, por edhe mënyra se si i shprehim ato. Për këtë arsye, komunikimi i folur mbështetet rregullisht nga gjuha e trupit dhe gjuha paralingvistike.

Elementet joverbale si lëvizja e trupit dhe shprehjet e fytyrës, si dhe elementet paraverbale që përfshijnë tonin dhe vëllimin e zërit, ndikojnë në mënyrën se si komunikojmë dhe ndihmojnë për t'i dhënë një formë të plotë asaj që synojmë të themi. Në të shkuarën, aspekti joverbal dhe paragjuhësor i gjuhës ka qenë pothuajse ekskluzivisht i lidhur me komunikimin e folur, ku biseda zhvillohej ballë për ballë, megjithatë, komunikimi me shkrim ishte i privuar nga aspektet e komunikimit joverbal pasi vetë natyra e tij përjashtonte praninë fizike të bashkëbiseduesve. Sa i përket komunikimit me shkrim, nuk ka dyshim se ai ka qenë një nga shpikjet më të rëndësishme për shoqërinë njerëzore, duke shtuar një mjet të ri komunikimi, risia kryesore e të cilit përfaqësohej nga mundësia e shënimit të përhershëm të informacionit, ngjarjeve, emocioneve dhe mendimeve të tyre. Shkrimi gjatë evoluimit të tij mori forma të ndryshme dhe pësoi modifikime në lidhje me kulturën dhe periudhën historike të cilës i përkiste.

Ngjarja revolucionare në shkrim ishte padyshim shpikja e shtypshkronjës së lëvizshme me të cilën shkrimi arriti një fazë të re zhvillimi. Në kohët moderne, po aq revolucionar ka qenë digjitalizimi i komunikimit të shkruar me të cilin një pjesë e teksteve është shndërruar në formë digjitale dhe është zhvendosur në internet. Zhvillimi teknologjik ka arritur në atë pikë sa është pothuajse e pamundur të imagjinohet jeta jonë e përditshme pa mesazhe të menjëhershme, email dhe platforma sociale gjithnjë e më të shumta në të cilat është e mundur të gjesh shembuj të ndryshëm të prodhimit të shkruar¹. Në këtë punim shkencor do të trajtoj prirjet e gjuhës në shqipen digjitale, cilat janë tendencat dhe orientimet e saj.

Ky studim përdor analizën tekstuale për të hulumtuar ndikimin e formave digjitale në stilin tradicional të shkrimit. Për të kuptuar mekanizmat që drejtojnë zhvillimin e gjuhës dhe komunikimit në epokën digjitale. Gjetjet ofrojnë referenca të vlefshme për zhvillimet e ardhshme teknologjike dhe shoqërore, duke theksuar rëndësinë e balancimit të inovacionit dhe ruajtjes së normave gjuhësore për komunikim të përgjegjshëm në epokën digjitale.

1. Shkrim digjital

Shkrimi digjital i referohet procesit të krijimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes në formë të shkruar në mjedise digjitale, si në kompjuterë, telefona celularë, tabletë dhe platforma të ndryshme sociale. Kjo prirje e re gjuhësore i ka nxitur linguistët ta përfshijnë atë në analizat e tyre për shkak të mënyrës se si po e transformon gjuhën². Teoritë e lingistikës për shkrimin digjital ndjekin disa qasje që analizojnë mënyrën se si teknologjia ka ndikuar gjuhën dhe komunikimin në platformat digjitale, të cilat teori shqyrtojnë ndryshimet strukturore dhe funksionale të gjuhës kur përdoret në formate të reja si mesazhet e shkurtra, rrjetet sociale dhe komunikimi online në përgjithësi. Prej shumë vitesh, komunikimi online ka qenë në qendër të reflektimit gjuhësor dhe zhvillimi i mediave sociale ka ngjallur kuriozitet edhe më të madh te gjuhëtarët, duke qenë se ka sjellë një ndryshim të rëndësishëm në metodat e komunikimit.

Kalimi nga gjuha tradicionale në atë digjitale ka sjellë disa prirje kryesore që reflektojnë ndryshimet në mënyrën si komunikojmë. Këto prirje përfshijnë adaptimin e formës së gjuhës për t'u përshtatur me kërkesat e komunikimit të shpejtë dhe në hapësira të kufizuara, si dhe evoluimin e strukturës dhe përdorimit të fjalëve dhe shenjave. Këto prirje të gjuhës tradicionale që evoluojnë në atë digjitale tregojnë një adaptim të shpejtë të gjuhës për t'iu përshtatur konteksteve të reja teknologjike dhe kulturore të epokës digjitale.

Ndërsa elemente të reja kanë dalë në pah në epokën digjitale, si është integrimi i gjuhëve të ndryshme në të njëjtën mbështetje, në mënyrë që teksti të ndërveprojë me tingujt, imazhet,

¹ Foshay, Raphael (2016): The Digital Nexus: Identity, Agency, and Political Engagement. Athabasca University. Fq. 11-15.

² Reyna, J / Hanham, J. / Meier, P. (2018): The Internet explosion, digital media principles and implications to communicate effectively in the digital space. Vol. 15. E-learning and Digital Media. Sage Journals. Fq. 35-52.

animacionet dhe videot³. Kjo kontribuoi në shfaqjen e hipertekstit, një nga risitë kryesore në shkrimin digjital, i cili përkufizohet si "një grup informacioni i ndarë në blloqe të shumta tekstesh, jo të lidhura në mënyrë sekuenciale, por sipas hierarkive dhe lidhjeve logjike që përdoruesi mund të vendosë se si të ndjekë"⁴. Pra **hiperteksti** në gjuhën digjitale është një strukturë tekstuale që lejon lidhjen interaktive midis dokumenteve dhe burimeve të tjera të informacionit përmes lidhjeve elektronike, të njohura si **hiperlidhje**.

Ndryshe nga teksti tradicional linear, hiperteksti i ofron përdoruesit mundësinë të ndërveprojë me informacionin në mënyrë jo-lineare duke kaluar nga një dokument në tjetrin nëpërmjet këtyre lidhjeve. Në ndarjen e ekspertëve gjuhësorë për pasojat pozitive dhe negative të gjuhës digjitale, një pjesë e konsiderueshme e tyre bie dakord se ka një zhvlerësim të shkrimit. Shkrimi digjital bëhet kalimtar, banal dhe shumë larg solemnitetit të shkrimit klasik⁵. Kjo do të thotë se qasje, lehtësia në një mjedis të madh përtej kufijve ka ulur cilësinë e përmbajtjes. Zhvlerësimi i përmbajtjes së teksteve digjitale është një fenomen që ndodh si rezultat i disa prirjeve të lidhura me mënyrën se si konsumojmë dhe prodhojmë informacion në mjediset digjitale. Ky zhvlerësim lidhet me uljen e cilësisë, vëmendjes dhe ndikimit të tekstit për shkak të faktorëve si fragmentimi, shpërndarja e shpejtë dhe e tepërt e informacionit, si dhe prirja për një fokus më të madh në formën sesa në përmbajtjen e thellë.

Një tjetër karakteristikë e shkrimit digjital është shkurtësia e fjalëve apo fjalive, madje duhet theksuar se kjo është tipike vetëm për shkrimin digjital. Qëllimi është të thuash sa më shumë me sa më pak fjalë në një hapësirë të kufizuar. Në fillim, parimi i shkurtësisë u imponua nga kufijtë teknikë të teknologjive të reja, veçanërisht të telefonisë celulare⁶. Arsyeja kryesore që njerëzit u ndjenë të detyruar të përmbledhin atë që donin të komunikojnë me vetëm disa fjalë ishte kostoja e mesazheve. Një mesazh SMS ka një kufi prej 160 karakteresh, përmes të cilit ne përpiqemi të shprehim të gjitha mendimet tona në mënyrën më të qartë dhe më koncize të mundshme.

Shkrimi i shkurtuar është miratuar gjithashtu nga platformat e komunikimit në internet, të cilat kufizojnë fizikisht numrin e karaktereve që mund të përmbajnë postimet e tyre. **Shkurtësia e shprehjes** është një nga elementët kryesorë të shkrimit digjital dhe përfaqëson një prirje të rëndësishme në mënyrën se si komunikojmë në mjediset digjitale. Kjo tendencë për t'u shprehur në mënyrë sa më të përmbledhur dhe të drejtpërdrejtë lidhet me disa faktorë dhe kontekste të veçanta të komunikimit në platforma online.

2. Gjuha e mediave sociale

Gjuha e mediave sociale është një formë komunikimi që ka evoluar shpejt me shfaqjen dhe përhapjen e platformave digjitale si Facebook, Instagram, Twitter (X), TikTok, dhe të tjera. Kjo gjuhë është e karakterizuar nga disa elemente që e dallojnë nga forma tradicionale e shkrimit dhe bisedës. Ajo përfshin prirje për koncizitet, interaktivitet, përdorimin e simboleve dhe imazheve për të komunikuar, si dhe një kombinim të gjuhëve të ndryshme dhe formave të shprehjes.

Rritja e platformave të mediave sociale ka lehtësuar lidhjet globale dhe ndërveprimet në kohë reale, duke kapërcyer kufijtë gjeografikë dhe zonat kohore ndërsa gjuha është përshtatur me shkurtësinë dhe informalitetin e mediave sociale, duke krijuar strategji të reja gjuhësore si shkurtesat, akronimet dhe hashtags duke u bërë pjesë e leksikut ditor. Megjithatë, sfidat lindin nga potenciali për keqkuptime dhe përhapja e dezinformatave në komunikimin online.

³ Tiempf, Siegfried (2017): Die Historische Dimension der Digitalisierung. Düsseldorf. Fq. 8.

⁴Digitales Wörterbuch der deutschen Sprache (DWDS). Online në: <https://www.dwds.de/wb/Hypertext?o=hypertext>

⁵ Carlini, Franko (2006): Lo stile del Web: parole e immagini nella comunicazione di rete. Taschenbuch. Fq. 40.

⁶ Rosi, Fabio (2018): Vera Gheno. Social-linguistica. Italiano e italiani dei social Network. Firenze. ISBN: 978-88-7667-646-8. Fq. 135-137.

Rrjedhimisht, stili joformal i të shkruarit reflektohet në përdorimin e gjuhës dhe zgjedhjen e fjalëve. Por duhet theksuar se kreativiteti dhe inovacioni gjuhësor që kanë sjellë mediat sociale sot në botë. Përdoruesit shpikin vazhdimisht fjalë, shprehje dhe meme të reja që përhapen shpejt nëpër platforma⁷. Nga ana tjetër, gjithë ky zhvillim gjuhësor në mediat sociale kanë pasur ndikim të rëndësishëm edhe në normat dhe konventat gjuhësore. Në platforma si Twitter, ku vendosen kufijtë e karaktereve, përdoruesit kanë zhvilluar mënyra inovative për të shprehur idetë komplekse në mënyrë koncize. Kjo ka çuar në popullarizimin e praktikave të tilla si heqja e zanoreve ("gr8" për "të mëdha") ose përdorimi i simboleve dhe numrave në vend të shkronjave ("2" për "to" ose "too")⁸. Për më tepër, ekspozimi i vazhdueshëm ndaj stileve dhe variacioneve të ndryshme gjuhësore në mediat sociale ka çuar në rritjen e pranimit dhe integritetit të formave jostandarde të gjuhës. Zhargoni, dialektet rajonale dhe madje edhe zhargoni specifik i internetit kanë gjetur rrugën e tyre në komunikimin e zakonshëm, duke mjegulluar kufijtë midis gjuhës formale dhe joformale. Platformat online ofrojnë mundësi për komunikim të menjëhershëm dhe asinkron, duke i lejuar individët të lidhen dhe të angazhohen me të tjerët përtej kufijve gjeografikë dhe kohorë. Kjo ka lehtësuar formimin e komuniteteve globale dhe shkëmbimin e ideve në një shkallë të paparë më parë⁹.

Pra, si përfundim **gjuha e mediave sociale** është dinamike, e shpejtë dhe e ndërveprueshme. Ajo kombinon elemente vizuale me ato tekstuale, është e mbushur me shkurtesa dhe simbole që lehtësojnë komunikimin dhe promovon përmbajtje të shkurtër, të përmbledhur dhe shpesh humoristike. Kjo gjuhë është vazhdimisht në zhvillim, duke reflektuar trendët kulturore, teknologjike dhe sociale në shoqërinë moderne.

3. Shqipja në epokën digjitale

Komunikimi online ka pasur një ndikim të madh në gjuhën shqipe në krahasim me gjuhët e tjera të huaja, duke qenë se ajo ka pasur një rrugë zhvillimi shumë të veçantë, ndaj forma e saj e standardizuar ka pasur ndikim të jashtëzakonshëm edhe në shtetet përreth Shqipërisë. Por me zhvillimin e komunikimit online, ka lindur nevoja për t'i dhënë një emër specifik dhe për të përcaktuar elementët kryesorë gjuhësorë që e dallojnë atë për shkak të ndikimit të madh dialektor të trevave shqipfolëse.

Në Maqedoninë e Veriut, Kosovë, Mal të Zi etj., edhe pse gjuha shqipe e standardizuar është pjesë përbërëse arsimore e institucionale, dialektet e përdorura zënë vendin kryesor në gjuhën e mediave sociale, dhe kjo ka bërë që të ketë zhvillime të reja në gjuhën shqipe. Platforma të rrjeteve sociale dhe interneti iu kanë dhënë mundësinë që dialektet dhe varietetet e shqipes të jenë më të pranishme dhe të përdoren më shpesh në komunikime. Për shembull, në Facebook dhe Instagram mund të gjesh postime në dialektin gegë apo toskë, duke kontribuar në pasurimin e gjuhës dhe në ruajtjen e diversitetit gjuhësor. Gjithashtu, përdorimi i gjuhës së folur të diasporës shqiptare ka krijuar forma të reja të ndërthurjes së shqipes me gjuhët e vendeve ku shqiptarët jetojnë, si italishtja, gjermanishtja apo anglishtja. Në të njëjtën kohë një sfidë e rëndësishme për gjuhën shqipe në epokën digjitale është standardizimi. Ndërkohë që përdorimi i formave joformale dhe dialektore është shumë i zakonshëm, ka një nevojë për të ruajtur një standard të gjuhës së shkruar, veçanërisht në kontekste formale dhe arsimore.

Institucionet dhe akademitë gjuhësore po përpiqen të ruajnë dhe promovojnë përdorimin e saktë të gjuhës shqipe në të gjitha format e komunikimit digjital, por kjo përballë një bote ku ndryshimet gjuhësore ndodhin shumë shpejt. Sigurisht që **gjuha shqipe në epokën digjitale** ka pësuar ndryshime dhe zhvillime të dukshme, të cilat reflektojnë ndryshimet më të gjera që po

⁷ Thurlow, C. / Poff, M. (2013): Computer-mediated communication. In The Handbook of Language and Media. Fq. 290-308.

⁸ Giroux, J./ Roth, F. / Herzog, M. (2013): Using ICT & Social Media in Disasters: Opportunities & Risks for Government. [Background Document]. Third Special Report, Center for Security Studies (CSS), Zurich: ETH.

⁹ Danet, B. / Herring, S. C. (Eds.): (2007). The Multilingual Internet: Language, Culture, and Communication Online. Oxford University Press.

ndodhin me gjuhët e tjera në mjediset digjitale. Teknologjia dhe interneti kanë krijuar një hapësirë ku shqipja ka hyrë në një fazë të re, ku bashkëvepron me forma të reja komunikimi, adoptime të gjuhëve të huaja dhe krijimin e një stili unik të shprehjes në mediat sociale, platforma online dhe përmbajtje digjitale. Një nga karakteristikat e saj është ndikimi i anglishtes, fjalë si "like", "post", "share", "follow", "scroll", "upload", dhe shumë terma të tjerë teknikë janë adoptuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të përzier në komunikimin e përditshëm. Shpesh, në bisedat e shkruara, përdoruesit ndërthurin fjalë të huaja (kryesisht anglisht) me shqipen, sidomos në bisedat digjitale joformale. Ky fenomen, ndonëse e bën komunikimin më të thjeshtë për brezat e rinj, mund të jetë një sfidë për ruajtjen e pastërtisë gjuhësore. Ashtu si në gjuhë të tjera, përdorimi i **shkurtimeve** dhe **akronimeve** është i zakonshëm në komunikimin në shqip. Fjalë si "flm" (faleminderit), "klb" (kalo bukur), "sps" (ska perse) etj., përdoren për të kursyer kohë dhe hapësirë në mesazhe.

Gjuha shqipe në epokën digjitale përballet me sfida të reja, por gjithashtu ka mundësi të jashtëzakonshme për t'u zhvilluar dhe për t'u përshtatur me botën moderne. Ndërveprimi me gjuhët e huaja, përdorimi i mediave sociale dhe rritja e përmbajtjeve multimediale në shqip janë vetëm disa nga elementet që po ndikojnë në këtë evolucion. Ndërkohë që forma joformale e shprehjes është në rritje, është e rëndësishme që të ruhet një balancë midis inovacionit gjuhësor dhe ruajtjes së standardeve të shqipes së saktë dhe të pasur.

4. Metodologjia e kërkimit

Objekti i kësaj teze studimi është hulumtimi i karakteristikave kryesore të gjuhës shqipe në mediat sociale. Për ta arritur atë për një muaj rresht, 1 gusht 2024-1 shtator 2024, janë vëzhguar shembuj të ndryshëm, në platformën e Instagramit, e cila është një nga më të përdorurat në Maqedoninë e Veriut, por jo vetëm, nga të rinjtë, duke u bërë kështu një burim i pasur i shprehjeve dhe bisedave mes të rinjve.

Falë përhapjes së tij të gjerë mes të rinjve, Instagram është bërë një burim i pasur i shprehjeve tipike të bisedave mes tyre, por edhe gjuhës që zhvillohet. Kryesisht u fokusova në profilet publike të njerëzve me ndikim në shoqërinë shqiptare, të cilët kanë shpërndarë foto dhe shkrime nga përditshmëria e tyre, kryesisht spontane. Shembujt janë pjesë e hulumtimit që synon të analizojë shqipen në nivele drejtshkrimore, morfologjike, sintaksore dhe leksikore. Në nivele të ndryshme analize, shfaqen risitë dhe tiparet themelore të varietetit të ri gjuhësor midis të shkruarit dhe të folurit.

• Analiza drejtshkrimore

Nga pikëpamja drejtshkrimore, gjuha shqipe në mediat sociale karakterizohet nga përdorimi i veçantë i shenjave grafike (shkronjat dhe kombinimet e shkronjave) dhe shenjat paragrafematike (theksat, apostrofat dhe shenjat e pikësimit). Interneti ka ndryshuar mënyrën se si ne përdorim sistemin tradicional të pikësimit. Shenjat e pikësimit nuk shërbejnë vetëm për të segmentuar ose për të përcaktuar marrëdhëniet sintaksore dhe logjike ndërmjet pjesëve të tekstit, por marrin edhe një funksion dytësor që konsiston në riprodhimin e shprehjes së gjuhës së folur. Sociolinguistja Anila Çepani, në një analizë të saj vë dukje "një prirje drejt polarizimit të shenjave të pikësimit" të shqipes në mediat sociale, "një përsëritje të tepruar të shenjave të pikësimit që tregojnë shkallën intensitetit të ndjesive për ato që thuhet në bisedë, sa më i madh numri i shenjave të pikësimit, aq më të forta janë përjetimet e bashkëbiseduesve"¹⁰, duke fituar kështu një popullaritet të papritur në epokën digjitale. Për më tepër, zhvillimi i shkrimit digjital ka çuar në thjeshtimin e shenjave të pikësimit.

¹⁰ Anila, Çepani (24.02.2020): Studim, Veçori gjuhësore të shqipes së shkruar në komunikim virtual. Online në: <https://tradita.org/2020/02/24/studim-vecori-gjuhesore-te-shqipes-se-shkruar-ne-komunikim-virtual/>.

Ja disa shembuj të sistemit të pikësimit të përdorur në Instagram:

- (1) cfar po thu????
- (2) per nje meee.....
- (3) ska mundsi!!!!

Ndërsa pika e zakonshme në fund të fjalisë thuajse është zhdukur nga përdorimi i gjuhës shqipe në Instagram, duke ia zënë vendin gjithnjë e më shumë emoji, të cilat janë kthyer në një lloj pikësimit shprehës.

- **Zgjatja e zanoreve**

Një tjetër karakteristikë e shqipes digjitale nga të rinjtë është zgjatja e zanoreve, si një nga prirjet e reja të shkrimit në internet që duket se bie në kundërshtim me shkurtësinë që synojnë tekstet në mediat sociale. Në korpus vërehet prania e fortë e përsëritjeve të zanoreve fundore me qëllim shprehës. Kjo është një nga strategjitë komunikuese të skripteve të reja që synon simulimin e shqiptimit shprehës ose të ndryshëm nga standardi që karakterizon të folurit. “Nga të dhënat e studimit tonë vihet re se përsëritja e disa zanoreve ose bashkëtingëlloreve të caktuara përdoren në mënyrë kreative në shumë situata për të shprehur qëndrime emocionale, pa i dalluar në negative apo pozitive”¹¹. Më publikimet e përzgjedhura për këtë studim ja disa shembuj:

- (4) Sa buuuuukur që po dukeshhhh
- (5) Jooooo, veeeertet????
- (6) Kuuujna po i thuuuu bre!

- **Përdorimi i shkronjave të mëdha**

Ky rregull i gjuhës shqipe thuajse nuk ekziston më në rrjetin social Instagram, nga të rinjtë. Në botën digjitale, shkronja e madhe ka marrë një kuptim dhe funksion specifik, sidomos në komunikimin e shkurtër, siç janë mesazhet në rrjetet sociale, bisedat me tekst dhe postimet online. Këto ndryshime janë ndikuar nga nevoja për të transmetuar emocionet, tonin, dhe për të tërhequr vëmendjen në një mjedis ku mesazhet janë të shkurtra dhe dinamike. Një nga përdorimet më të njohura të **shkronjave të mëdha** në bisedat digjitale është për të shprehur **zemërim, zhgënjim, ose emocione të forta**. Shkrimi me shkronja të mëdha, ndonëse mund të perceptohet si shkelje e rregullave tradicionale, është një pasqyrim i evolucionit të gjuhës dhe mënyrave të komunikimit në epokën digjitale.

- (7) isha n PUNE
- (8) ASNJEHERE!
- (9) Faleminers per DASHNIN tate...

4.1 Drejtshkrim i thjeshtuar: Tipari më evident i fazës së parë të shkrimit digjital është sigurisht përdorimi i sistemeve takografike që nënkupton një mënyrë e veçantë për të shkruar fjalë ose fjali të tëra duke përdorur shkurtesa. Fillimi i përdorimit të takografisë online është i lidhur me çështjet teknologjike dhe ekonomike të origjinës së komunikimit online. Lidhja me internetin ishte e shtrenjtë dhe programet e komunikimit kompjuterik mund të përdoreshin vetëm online, kështu që ishte e nevojshme të planifikoje mesazhin kur të ishte lidhur dhe ta dërgoje shpejt për të kursyer kohë dhe para. “Disa nga elementet takografike të përdorura më shumë janë emotikonat, logogramet, shkurtime, shkurtesat apo akronimet. Në të dhënat tona kemi vënë re pak shembuj logogramesh [Simist (pesimist) 3gove (tregove)] sepse përdoruesit përdorin më shumë logograme të fjalëve të anglishtes”¹².

- (10) Flm (faleminderit)

¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

- (11) Klm (kalofsh mirë)
- (12) Zmr (zemër)

- **Analiza morfologjike**

Në shqipen e sotme vihet re një prirje drejt ekzagjerimit që nga pikëpamja gjuhësore arrihet nëpërmjet përdorimit të parashtesave superlative. Nga analiza e korpusit, parashtesa super është mjaft e shpeshtë. Në gjuhën bashkëkohore u jep vlerën superlative e fjalëve të cilave u paraprihet ose tregon një gjendje të tepruar ose tejkalim të një kufiri. Në korpus parashtesa super shfaqet më së shumti në emra, mbiemra dhe folje.

- (13) sot jam super keq
- (14) Superrr e lumtur, diplomovaaa....
- (15) gjithçka super!!!

Morfologjia shqipe në mjedisin digjital përfshin ndryshime të lidhura me formimin dhe përdorimin e fjalëve, përfshirjen e huazimeve, shkurtimet, dhe forma të thjeshtuara të strukturave gramatikore. Struktura të caktuara të anglishtes, sidomos ato që lidhen me teknologjinë dhe mediat sociale, janë përvetësuar direkt pa shumë ndryshime, duke përfshirë jo vetëm fjalët, por edhe mënyrën e formimit të fjalive dhe frazave. Përmes përzierjes së shqipes me fjalë të huaja, shfaqen neologjizma ose fjalë të kompozuar që janë të lidhura me teknologjinë dhe komunikimin në internet. Si “shpërndarje” për "share" ose "ripostim" apo "hashtag-u". Këto fjalë shpesh marrin trajtë shqipe duke iu shtuar mbaresa të shqipes, si në rastin e emrit "hashtag" që bëhet "hashtag-u". Në komunikimin e shpejtë digjital, shpesh shmangen disa elemente morfologjike, sidomos forma të plota të nyjave, lidhëzave dhe shprehjeve gramatikore. Fjalitë janë më të shkurtuara dhe të thjeshta si: "Kam kohë" në vend të "Unë kam kohë".

- **Analiza sintaksore**

Nga pikëpamja sintaksore, ndikimi i gjuhës së folur në gjuhën e shkruar mund të shihet në preferencën e gjuhës shqipe për fjali të shkurtra dhe të thjeshta. Fjalitë parataktike ndaj të cilave priret shkrimi digjital karakterizohen nga shkurtësia e tyre e fjalive dhe thjeshtësia sintaksore që përjashton ndërtimin e fjalive të nënrenditura. Përdorimi i fjalive të shkurtra do të thotë, përveç shmangies së rrezikut të krijimit të një teksti kompleks dhe të vështirë për t'u lexuar, ta mbash atë gjallë vëmendjen e lexuesve të saj të mundshëm. “Për t’iu përshtatur kontekstit të komunikimit online, bashkëbiseduesit përdorin një gjuhë ku vihet re prirja për reduktimin e formave të fjalëve, thjeshtimin e strukturave, përdorimin fjalive të shkurtra e të paplota, madje pjesët e fjalive të përbëra ndahen në fjali të shkurta, pavarësisht se janë të varura nga njëra-tjetra, shmangien nga rendi i drejtë i gjymtyrëve në fjali”¹³.

Ajo çfarë vihet re pothuajse në të gjitha postimet e korpusit të hulumtuar ishte mungesa e shkronjës ç dhe ë. Shqipja digjitale për arsye të ndryshme tashmë i mungojnë në mënyrë të dukshme këto dy shkronja, të cilat janë zëvendësuar nga e dhe c.

Shqipja digjitale po karakterizohet gjithnjë e më shumë nga stili nominal, fjali emërore në të cilat mungon folja që vepron si kallëzues. Stili nominal lidhet me një nga qëllimet e shkrimit social për të thënë sa më shumë me sa më pak fjalë. Prania e madhe e frazave emërore në tekstet që shfaqen si tregime nuk është befasuese pasi ato priren të jenë koncize dhe të vënë theksin në informacionin kryesor që dëshironi t'u përcillni lexuesve shpejt dhe menjëherë.

- (16) Shtëpi, familje, dashni
- (17) Surprizë, lumturi, ditëlindja ime

¹³ Po aty.

(18) rutina e mëngjesit, kujdesi për fytyrën, unë dhe ai

- **Analiza leksikore**

Risitë leksikore në gjuhën shqipe të mediave sociale janë ato që zgjojnë kureshtjen më të madhe dhe përfaqësojnë veçoritë e mëdha të komunikimit online. Për sa i përket ndikimit që kanë mediat sociale në gjuhë, opinioni është i përhapur se mediat e reja kanë degraduar gjuhën shqipe. “Nëse kjo mënyrën e të komunikuarit bëhet e zakonshme në çfarëdo ambienti apo situatë, pra jo vetëm një komunikim i shpejtë mes shokësh, atëherë duhet të shqetësohemi sesa thellë do të shkojë e sa ndikim do të ketë në gjuhë. Kjo mund të përbëjë rrezik sidomos por ata persona që nuk kanë formimin e duhur gjuhësor dhe do të ngelin në shkrimet e tyre, trajtat gabuara të fjalëve, pa arritur të bëjnë dallimin se cila është e drejta”¹⁴.

Megjithatë, jo të gjithë e ndajnë këtë mendim. Rrjetet sociale kanë sjellë ndryshime të mëdha në përdorimin e gjuhës shqipe dhe dialekteve të saj, kjo nuk do të thotë se ndryshimet kanë qenë thjesht negative, madje duket se e kanë pasuruar në këtë aspekt. Gjuha shqipe, si një gjuhë unike në botë ka qenë immune nga ndikimi i gjuhëve tjera, por që nga standardizimi i saj duket se dialektet që pasuronin atë mbetën jashtë përdorimit të tyre. Si rrjedhojë epoka digjitale rigjallëroi edhe njëherë shqipen, duke futur në përdorim krejt dialektet dhe nëndialektet e saj. Ajo çka vihet re në analizën leksikore në shembujt që kam hulumtuar është se risitë leksikore nuk përfaqësohen domosdoshmërisht nga futja e fjalëve krejtësisht të reja, por nga ndërhyrja në fjalë që ekzistojnë tashmë në një gjuhë.

Në komunikimin digjital, mënyra më produktive me të cilën mund të ndërhyhet në leksik janë shkurtesat, të cilat konsistojnë në zvogëlimin ose shkurtimin e fjalëve me synimin për të kursyer hapësirë ose për ta bërë bisedën më të thjeshtë dhe më të shpejtë. Sipas analizës së shembujve mund të konkludoj se akronimet angleze mbizotërojnë mbi ato shqipe.

(19) Omg vertet, mos m thuj(Oh my God)

(20) Btw sot isha deri n fakultet (by the way)

(21) BBF (best boy friend)

Gjuha e shkruar e përdorur në rrjetet sociale, veçanërisht në Instagram, është më larg gjuhës së shkruar tradicionale, si pasojë e faktorëve të ndryshëm, prirjet e saj janë të jetë më spontane dhe më pranë të folurës së përditshme. Duke pasur prirje të bëhet më i shpejtë, më i menjëhershëm dhe dialogues.

5. Përfundim

Ndikimi transformues i mediave digjitale në stilet gjuhësore dhe komunikimin mes njerëzve është i jashtëzakonshëm. Evolucioni nga komunikimi tradicional i bazuar në tekst në një peizazh të shumanshëm që përfshin teksti, imazhet dhe format video kanë sjellë përmirësime pozitive dhe sfida. Platformat digjitale janë bërë arena dinamike ku gjuha pëson risi të vazhdueshme dhe gjuha shqipe nuk bën përjashtime. Teksti digjital ka marrë karakteristika të reja që e largojnë atë nga forma tradicionale e teksteve në letër, duke modifikuar në mënyrë të pashmangshme si gjuhën shqipe, ashtu edhe të gjitha gjuhët e tjera të përdorura në internet. Brenda dialekteve gjithmonë e më të shfaqura tashmë shqipja përfaqëson një formë hibride që shquhet për ndërthurjen e disa karakteristikave kryesore të gjuhës së shkruar dhe të folur.

Bazuar në rezultatet e marra nga hulumtimi ynë, arrijmë në përfundimin se nuk është e mundur të reduktohet gjuha që shfaqet në rrjetet sociale në një gjuhë të vetme uniforme dhe identike. Gjuha nuk përcaktohet vetëm nga mjetet e komunikimit, por edhe nga faktorë të tjerë si mosha, origjina, statusi socio-ekonomik i përdoruesve, por edhe nga qëllimi i teksteve të shkruara. Prandaj, nga analiza ortografike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore e shembujve dalin disa

¹⁴ Po aty.

tipare të përbashkëta që dallojnë shqipen e shkruar, e cila bazohet në atë standarde me atë digjitale.

Mendimet e gjuhëtarëve ndahen në dy grupe, nga njëra anë, mendimi se interneti ka degraduar gjuhën shqipe, duke nënvizuar si arsye kryesore importimin e një numri të tepëruar anglicizmash dhe një tolerancë të lartë ndaj gabimeve drejtshkrimore. Nga ana tjetër, zhvillimi i komunikimit të ndërmjetësuar nga kompjuteri ka inkurajuar një numër të madh njerëzish të zakonshëm që të provojnë dorën e tyre në të shkruarit në formën e teksteve të shkurtra, të fragmentuara. Në realitet, komunikimi online ka ndihmuar në thjeshtimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe standarde me dialektet e saj në shtetet shqipfolëse.

Megjithatë si përfundim duhet të theksoj se duhet gjetur një ekuilibër delikat midis përparësitë e inovacionit dhe ruajtjes së normave gjuhësore, duke i pranuar sfidat dhe adresuar ato në mënyrë proaktive sepse bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet platformat digjitale, institucionet arsimore dhe përdoruesit janë thelbësore për evoluimin e përgjegjshëm të gjuhës në epokën digjitale.

Referencat

- [1]. Anila, Çepani (24.02.2020): Studim, Veçori gjuhësore të shqipes së shkruar në komunikim virtual. Online në: <https://tradita.org/2020/02/24/studim-vecori-gjuhesore-te-shqipes-se-shkruar-ne-komunikim-virtual/>.
- [2]. Carlini, Franko (2006): *Lo stile del Web: parole e immagini nella comunicazione di rete*. Taschenbuch.
- [3]. Danet, B. / Herring, S. C. (Eds.): (2007). *The Multilingual Internet: Language, Culture, and Communication Online*. Oxford University Press.
- [4]. Digitales Wörterbuch des deutschen Sprache (DWDS). Online në: <https://www.dwds.de/wb/Hypertext?o=hypertext>
- [5]. Foshay, Raphael (2016): *The Digital Nexus: Identity, Agency, and Political Engagement*. Athabasca Univesity.
- [6]. Giroux, J./ Roth, F. / Herzog, M. (2013): *Using ICT & Social Media in Disasters: Opportunities & Risks for Government*. [Background Document]. Third Special Report, Center for Security Studies (CSS), Zurich: ETH.
- [7]. Reyna, J / Hanham, J. / Meier, P. (2018): *The Internet explosion, digital media principles and implications to communicate effectively in the digital space*. Vol. 15. *E-learning and Digital Media*. Sage Journals.
- [8]. Rosi, Fabio (2018): *Vera Gheno. Social-linguistica. Italiano e italiani dei social Network*. Firenze. ISBN: 978-88-7667-646-8.
- [9]. Tiempf, Siegfried (2017): *Die Historische Dimension der Digitalisierung*. Düsseldorf.
- [10]. Thurlow, C. / Poff, M. (2013): *Computer-mediated communication*. In *The Handbook of Language and Media*.